



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË
VENDIM

Nr/57 Datë 30.12.08

Për miratimin e fondit prej 207 500 Lekësh për koncertin e
Korit Pax Dei

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Marketingut dhe Turizmit "Për miratimin e fondit prej 207 500 Lekësh për koncertin e Korit Pax Dei", në zbatim të ligjit nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "dh", ligjit nr 8399 dt. 09.09.2008 "Për buxhetin lokal", Ligjit nr 9836 dt. 26.11.2007 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2008", Udhëzimit nr 4 dt. 17.01.2008 të M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2008", Udhëzimit nr 258 dt.15.02.2008 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2008", si dhe V.K.B. nr. 12 dt. 18.03.2008 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2008", si dhe Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI:

1. Të miratojë fondin shtese prej 207 500 lekësh nga fondi rezerve i Bashkisë për koncertin e Korit Pax Dei sipas kesaj strukture buxhetore:

Pakesohet 00 04980 05 Art 609 0000 - 207 500 (Bashkia)

Shtohet 00 08250 05 Art 602 0000 + 207 500 (Qendra Ek. e Kultures)

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Marketingut dhe Turizmit, Qendra Ekonomike e Kultures dhe Drejtoria e Financës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Raimonda NASE